

**AKTI I THEMELIMIT**  
**PËR SHOQËRINË “GLOBAL EVOLUTION XAV” SHPK**

**FORMIMI I SHOQËRISË**

Sot në Tiranë në datën 19 Prill 2022 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “GLOBAL EVOLUTION XAV” shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

**1. Nazif Dinoshi**, i biri Bilal, i datëlindjes 08/02/1985 lindur dhe banues ne Tirane ,Rruga "Liqeni i Thate", Pallati nr 2, Ap29, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal 150208054L.

**2. Alfred Prela**, i biri Prele, i datëlindjes 04/01/1975 lindur ne Salce dhe banues ne Tirane ,Rruga "Elbasanit", madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal H50104030K

**SELIA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria tregtare "GLOBAL EVOLUTION XAV " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin **Tiranë, Rruga "Islam Alla", Nr 4/700-N14, Kati 2**, me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria Tregtare “GLOBAL EVOLUTION XAV” SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 000 000 lekë (nje milion lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndare në dy kuota me vlerë nominale 500 000 lekë secila (peseqind mije lekë).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. **Nazif Dinoshi**, zotërues i një kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 500 000 lekë (peseqind mije lekë).
2. **Alfred Prela**, zotërues i një kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 500 000 lekë (peseqind mije lekë).

Kapitali fillestar nuk është paguar.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË:**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “GLOBAL EVOLUTION XAV” shpk do të jetë :

Import - Eksport, Call-center ,Marketing dhe shitje ne distance,Tregeti dhe dhenie me qira te automjeteve .Sherbime ndermjetesimi.Te tjera aktivitete te pa permendura qe i lejon ligji.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

1.Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

a- për ndryshime në statut

b-emërimin dhe shkarkimin e administratorit

c-miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.

d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit

e-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë , është **Alfred Prela** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

### **BAZA LIGJORE**


E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

### **ORTAKET:**

**Nazif Dinoshi**



**Alfred Prela**

